REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 nëntor 2026
Nr. ref.:AGJ3257/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI190/25

Parashtrues

Ajet Ukshini

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave në lëndën [C. nr. 286/19] në Gjykatën Themelore në Gjakovë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ajet Ukshini (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore të zhvilluara përkitazi me lëndën civile-pronësore [C. nr. 286/19] në Gjykatën Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave të zhvilluara në Gjykatën Themelore, me pretendimin se mosvendosja e lëndës [C. nr. 286/19] cenon të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 korrik 2025, parashtruesi i kërkesës, përmes postës, dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 18 korrik 2025, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [nr. GJR. KI190/25], caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Vendimit [nr. KSH. KI190/25] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Radomir Laban dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).

7. Më 22 korrik 2025, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi plotësimin e kërkesës së tij.

8. Më 30 korrik 2025, parashtruesi i kërkesës, përmes postës elektronike, plotësoi kërkesën duke bashkëngjitur dokumentet e kërkuara.

9. Më 25 gusht 2025, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë, përfshirë autorizimin për përfaqësim dhe disa dokumente që ishin dorëzuar tek gjykatat e rregullta.

10. Më 3 prill 2026, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga kjo e fundit që ta informojë Gjykatën përkitazi me: (i) fazën në të cilën gjendet

rasti i parashtruesit; si dhe (ii) veprimet e ndërmarra nga Gjykata Themelore përkitazi me rastin e parashtruesit të kërkesës.

11. Më 20 prill 2026, Gjykata Themelore dorëzoi informatat e kërkuara nga Gjykata.

12. Më 3 shtator 2026, Gjykata vlerësoi se kërkesa duhet të shqyrtohet sërish në një seancë të ardhme.

13. Më 3 shtator 2026, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë dosjen e plotë të lëndës.

14. Më 18 shtator 2026, Gjykata Themelore dorëzoi dosjen e plotë të lëndës.

15. Më 4 nëntor 2026, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, vendosi që: (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor; si dhe (iii) të urdhërojë Gjykatën Themelore që jo më larg se 5 maj 2027, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës.

Përmbledhje e fakteve

16. Nga shkresat e lëndës rezulton se objekti i kontestit gjyqësor pranë Gjykatës Themelore është e drejta e pronësisë së parashtruesit të kërkesës përkitazi me paluajtshmërinë e evidentuar si ngastër kadastrale [nr. 1218], me kulturë mal i klasës II, në sipërfaqe prej 06.84.27 ha sipas fletëposedimit [nr. 230], e cila ndodhet në Komunën e Gjakovës në Zonën Kadastrale Brovinë (në tekstin e mëtejmë: prona kontestuese).

17. Më 17 korrik 2001, paraardhësi i parashtruesit të kërkesës YU së bashku me paditësit tjerë ZU, AU dhe BU parashtruan padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) kundër O. P. Ekonomia e Pyjeve-Gjakovë (tani Agjencia Pyjore e Kosovës, në tekstin e mëtejmë: APK), për vërtetimin e së drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 1,000.00 dem-marka gjermane, e cila ishte evidentuar me numër të lëndës C. nr. 305/2001.

18. Më 29 tetor 2001, Gjykata Komunale caktoi seancën e shqyrtimit kryesor në lëndën C. nr. 305/2001, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësve Teki Bokshi, ndërsa e paditura APK nuk ka prezantuar edhe pse kishte qenë e ftuar në mënyrë të rregullt. Në atë seancë, përfaqësuesi i paditësve kishte kërkuar sqarim rreth emërtimit të saktë të palës së paditur APK, pasi që kjo e fundit kishte pësuar ndryshime statusore. Gjykata Komunale kishte vendosur që ta ndërpres procedurën lidhur me këtë çështje juridike, përderisa i autorizuari i paditësve ta rregullojë padinë lidhur me emërtimin e palës së paditur për shkak të ndryshimeve statusore.

19. Më 17 shkurt 2005, përfaqësuesi i paditësve paraqiti kërkesë për vazhdim të procedurës kundër të paditurës AKP, me objekt të çështjes-vërtetim i të drejtës në paluajtshmëri. Kjo çështje juridike më pas mori numrin e lëndës C. nr. 165/2005.

20. Më 15 qershor 2012, Gjykata Themelore kërkoi informata nga Komuna e Gjakovës nëse palët paditëse ZU dhe YU paraardhësi i parashtruesit të kërkesës, kanë vdekur dhe çregjistruar nga regjistrat përkatës. Më 29 qershor 2012, Komuna e Gjakovës njoftoi Gjykatën Komunale se palët paditëse kanë vdekur më 18 tetor 2000 dhe 11 shkurt 2010, përkatësisht.

21. Më 29 qershor 2012, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [C. nr. 165/2005] (i) ndërpreu procedurën gjyqësore për shkak të çështjes paraprake-vdekja e palëve paditëse; (ii) procedura do të vazhdojë në momentin kur trashëgimtarët e palëve marrin përsipër procedurën gjyqësore; ose (iii) kur Gjykata Themelore i thërret në bazë të propozimit të palës kundërshtare APK.

22. Më 16 prill 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë tashmë në Gjykatën Themelore, për vazhdimin e procedurës gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se duke pasur parasysh se kanë pushuar kushtet e ndërprerjes dhe se është trashëgimtarë, i propozon Gjykatës Themelore që procedura e ndërprerë të vazhdohet.

23. Më 24 janar 2020, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore me parashtresë-urgjencë për caktim të seancës gjyqësore, duke theksuar se e njëjta duhet caktuar sa më parë që të jetë e mundur për shkak se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Të njëjtën kërkesë, parashtruesi i kërkesës e kishte paraqitur në Gjykatën Themelore më 7 mars 2022 dhe 16 nëntor 2023, përkatësisht. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se procedura në këtë çështje juridike ishte ndërprerë me Aktvendimin e Gjykatës Komunale [C. nr. 165/2005] të 29 qershorit 2012.

24. Në një datë të paspecifikuar, Gjykata Themelore caktoi seancën përgatitore më 4 korrik 2024.

25. Ndërkohë, më 21 qershor 2024, Avokatura Shtetërore e Kosovës iu drejtua Gjykatës Themelore duke kërkuar shtyrje të seancës për shkak të angazhimeve të avokatit të lëndës dhe se nuk është e mundur të angazhohet një avokat tjetër zëvendësues.

26. Më 4 korrik 2024, Gjykata Themelore mbajti seancën përgatitore në të cilën, parashtruesi i kërkesës i propozoi Gjykatës Themelore që seanca të shtyhet me arsyen se paraprakisht ishte njoftuar se Avokatura Shtetërore e Kosovës nuk do jetë prezentë në seancën përgatitore, ashtu që në seancën tjetër edhe do shqyrtojë legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve në procedurë. Gjykata Themelore gjatë seancës përgatitore: (i) aprovoi propozimin për shtyrje të seancës, dhe (ii) vendosi që seanca e radhës të mbahet më 24 korrik 2024.

27. Më 24 korrik 2024, Gjykata Themelore mbajti seancën përgatitore në çështjen juridike me numër (C. nr. 286/2019), duke përcaktuar: **(i)** aprovohet ndryshimi i padisë dhe kërkesëpadisë duke përcaktuar nëntë (9) paditës të rinj, përfshirë dhe parashtruesin e kërkesës dhe vlerën e kontestit në shumën prej 5,000.00 euro kundër palës së paditur APK-së; **(ii)** obligoi palët paditëse përfshirë parashtruesin e kërkesës që të paguajnë taksën gjyqësore prej 40 euro; **(iii)** obligoi të autorizuarin e paditësve përfshirë parashtruesin e kërkesës që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim; **(iv)** konstatoi se padia e njërit prej paditësve konsiderohet e tërhequr; **(v)** aprovoi propozimin për nxjerrjen e ekspertizës gjeodezike dhe caktoi ekspertin përkatës; **(vi)** vendosi që sipas detyrës zyrtare të sigurojë shkresat e lëndëve të mëparshme [C. nr. 921/89] dhe [C. nr. 142/2000] për verifikimin e litispendencës; si dhe **(vii)** përcaktoi se seanca e daljes në vendngjarje do të caktohet pas sigurimit dhe verifikimit të shkresave të lartcekura.

28. Ndërkohë, më 1 korrik 2025 dhe më 29 dhjetor 2025, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Gjykatës Themelore, duke kërkuar caktim urgjent të seancës gjyqësore. Në këto parashtresa, parashtruesi i kërkesës kishte ngritur të njëjtat pretendime sikurse në parashtresat e mëparshme lidhur me caktim sa më të shpejtë të seancës gjyqësore.

29. Më 29 dhjetor 2025, lënda bartet tek gjyqtari FH.

30. Më 9 shkurt 2026, gjyqtari i çështjes kishte kërkuar nga arkiva e Gjykatës Themelore që të sigurojnë shkresat e lëndës me numra: C. nr. 921/1989 dhe C. nr. 12/2000. Të njëjtit, brenda afatit ligjor i janë siguruar lëndët dhe se të njëjtat janë pjesë përbërëse të shkresave të lëndës C. nr. 286/2019.

31. Pas sigurimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe marrë parasysh se gjyqtari i çështjes është ndryshuar në këtë lëndë, konform dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK) është caktuar rishtas seanca e shqyrtimit përgatitor më 4 qershor 2026, duke filluar nga ora 13:30/h.

32. Kjo është rrjedha e lëndës C. nr. 286/2019. Në këtë lëndë përmenden edhe dy (2) lëndë tjera me numra C. nr. 142/2000 dhe C. nr. 921/1989.

33. Më 24 korrik 2026, Gjykata Themelore mbajti seancë përgatitore dhe përpiloi procesverbal për lëndën [C.nr.286/19] me ç 'rast parashtruesi i kërkesës i ishte palë paditëse ndërsa APK-ja palë e paditur. Gjykata Themelore konstatoi: I. VAZHDOHET procedura e ndërprerë në këtë çështje juridike me objekt të kontestit vërtetim i pronësisë. II. Ndaj këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e veçantë.

34. Më 16 shtator 2026, Gjykata Themelore mbajti seancë për dalje në vend dhe përpiloi procesverbal për lëndën [C.nr.286/19]. Gjykata Themelore konstatoi: I. DETYROHET eksperti i gjeodezisë që në afat prej 30 ditësh që nga dita e sotme gjykatës t'ia prezantojë raportin me shkrim i cili duhet të përmbajë të dhënat e kërkuara si në aktvendim procedural të datës 24.07.2026; II. Seanca e daljes në vend përfundoi; III. Seanca e radhës do të caktohet pas plotësimit të kushteve ligjore, palët ndërgjyqëse do të ftohen me ftesa të rregullta, e të cilëve së bashku me ftesë gjykata do t'iu përcjellë një kopje të këtij procesit të kompjuterizuar dhe një kopje të ekspertizës.

i. Procedurat gjyqësore të lëndëve paraprake [C.nr. 921/1989] dhe [C.nr. 142/2000]

35. Më 21 nëntor 1989, në Gjykatën Komunale është paraqitur padi nga AU kundër O.P. Ekonomia e Pyjeve - Gjakovë, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, e cila është evidentuar me numër të lëndës [C. nr. 921/1989], ndërsa më 25 shtator 1991, Gjykata Komunale përmes aktvendimit e konsideroi të tërhequr këtë padi.

36. Më 20 nëntor 1991, në Gjykatën Komunale është paraqitur padi nga ZU, YU, AU dhe BU kundër O.P. Ekonomia e Pyjeve – Gjakovë, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, e cila fillimisht është evidentuar me numër [C. nr. 847/91], ndërsa më pas [C. nr. 142/2000], kurse më 28 maj 2001, Gjykata Komunale përmes aktvendimit e konsideroi të tërhequr këtë padi.

37. Më 17 tetor 2012, i autorizuari i paditësve paraqiti kërkesë për vazhdimin e procedurës në lëndën [C. nr. 142/2000].

38. Më 26 janar 2015, Gjykata Themelore përmes shënimit zyrtar konstatoi se aktvendimi për tërheqjen e padisë i 28 majit 2001 ishte bërë i plotfuqishëm dhe se kërkesa për vazhdimin e procedurës konsiderohet jolëndore.

39. Megjithatë, për shkak të ndërrimit rishtas të gjyqtarit të çështjes, në këtë lëndë është caktuar seanca përgatitore më 4 qershor 2026, duke filluar nga ora 13:30/h.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se kohëzgjatja e procedurës civile pronësore [C. nr. 286/19] në Gjykatën Themelore, cenon të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

41. Parashtruesi i kërkesës thekson se procedura gjyqësore ka filluar që nga viti 1991 dhe deri më sot nuk ka përfunduar. Ai pretendon se Gjykata Themelore është vonuar pa arsye në trajtimin e çështjes dhe ka dështuar që të nxjerrë një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm.

42. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se nuk ka kontribuar në zvarritjen e procedurës sepse ka qenë aktiv gjatë procedurës, ndërsa vonesat ia atribuon sjelljes së autoritetit gjyqësor. Po ashtu pretendon se përgjegjësia për zgjatjen e procedurës bie mbi Gjykatën Themelore, e cila nuk ka organizuar në mënyrë efikase administrimin e drejtësisë dhe nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes në kohë.

43. Përkitazi me këto pretendime, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), dhe duke iu referuar rasteve të së njëjtës *(Comingersoll S.A. kundër Portugalisë* (nr. 35382/97), Aktgjykimi i 6 prillit 2000, *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë* (nr. 76943/11), Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, *Scordino kundër Italisë* (nr.1), [DhM] nr. 36813, Aktgjykimi i 29 marsit 2006, *Bottazzi kundër Italisë*, nr. 34884/97, Aktgjykim i 28 korrikut 1999 dhe *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000), duke theksuar se shteti ka detyrim pozitiv të organizojë sistemin gjyqësor në mënyrë që të sigurojë zgjidhjen e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe se vonesat e tepërta cenojnë efikasitetin dhe besueshmërinë e drejtësisë. Po ashtu, ai i referohet rasteve (*Papachelas kundër Greqisë* nr. 31423/96, *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë* (nr. 12539/86), *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 9580/81), *Humen kundër Polonisë* (nr. 26614/95) dhe *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë* (nr. 41720/13)), për të argumentuar kriteret e vlerësimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës, siç janë kompleksiteti i çështjes, sjellja e palëve dhe e autoriteteve. Në vijim, parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve (*Martins Moreira kundër Portugalisë* (nr. 11371/84), *Lechner dhe Hess kundër Austrisë* (nr. 9316/81), *Probstmeier kundër Gjermanisë* (nr. 20950/92) dhe *Fisanotti kundër Italisë* (nr. 32305/96)), duke argumentuar se përgjegjësia për vonesat bie mbi shtetin dhe se faktorët si mbingarkesa e gjykatave apo reformat institucionale nuk mund të arsyetojnë zgjatjen e procedurave.

44. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (ii) të obligojë

kompensimin e dëmit material dhe jomaterial në shumë prej 100,000.00€ (njëqind mijë euro), për shkak të zvarritjes së paarsyeshme të procedurës gjyqësore.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1.Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

45. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

46. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

47. Gjykata më tej i referohet neneve 47 (Kërkesat individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
(Afatet)

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]

48. Në lidhje me afatshmërinë e kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston tejzgjatjen e procedurës në Gjykatën Themelore, për mosvendosje në kohë të lëndës civile pronësore [C. nr. 286/2019], e cila ende nuk ka përfunduar pranë kësaj të fundit. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit, gjegjësisht tejzgjatjen e procedurës pranë kësaj instance gjyqësore, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej katër (4) muajve.

49. Gjykata po ashtu i referohet pikës (a) të paragrafit 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës që përcakton:

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar;"

50. Lidhur me këtë, Gjykata, përmes praktikës së saj gjyqësore dhe duke u bazuar në atë të GJEDNJ-së, ka përcaktuar se për të paraqitur kërkesë para Gjykatës një person duhet të jetë "*viktimë*" e shkeljes kushtetuese, "*direkte*" apo "*indirekte*". Në kontekst të viktimës indirekte ose të tërthortë, praktika e Gjykatës është posaçërisht e konsoliduar në rrethana të pretendimeve para Gjykatës lidhur me dështimin e shtetit për të përmbushur detyrimet

pozitive për mbrojtjen e së drejtës në jetë sipas garancive të nenit 25 [E Drejta për Jetë] të Kushtetutës dhe nenit 2 (E drejta për jetën) të KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës: KI41/12, me parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati,* Aktgjykim i 26 shkurtit 2013, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga prindërit e të bijës së ndjerë; dhe KI129/21, me parashtruese *Velerda Sopi*, Aktgjykim i 7 marsit 2023, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga vajza e të ëmës së ndjerë). Ngjashëm, Gjykata ka vepruar edhe në kontekst të së drejtës për privatësinë dhe jetën familjare, të garantuar me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit përkatës (shih rastin KI56/18, me parashtrues *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga prindi i të ndjerit). Prandaj, në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, statusi i viktimës indirekte ose të tërthortë u është njohur vetëm familjarëve të ngushtë apo personave të afërm të cilët kanë arritur të dëshmojnë se kanë interes legjitim lidhur me çështjen në fjalë (shih gjithashtu rastin e Gjykatës: KI77/20, me parashtrues *Kujtim Zarari*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 nëntorit 2020, paragrafët 30-36, rast ky në të cilin Gjykata i ka pranuar cilësinë e viktimës indirekte ose të tërthortë bashkëshortes së parashtruesit të kërkesës, i cili kishte ndërruar jetë pas parashtrimit të kërkesës përkatëse në Gjykatë).

51. Gjykata ka sqaruar, rast pas rasti, që statusi i viktimës indirekte ose të tërthortë është po ashtu i ndërlidhur me natyrën e të drejtave që kontestohen para Gjykatës, përkatësisht nëse të drejtat përkatëse mund të cilësohen si të drejta të *"transferueshme"* apo jo. Sipas sqarimeve të dhëna përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, të drejtat që ndërlidhen me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në parim, por me përjashtime, cilësohen si të drejta të *"pa transferueshme"* (shih rastet e Gjykatës: KI14918, KI150/18, KI151/18, KI152/18, KI153/18, me parashtrues *Xhavit Aliu dhe 5 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 korrikut 2019, paragrafët 68-73; dhe rastin e GJEDNJ-së: *Biç dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 55955/00, Aktgjykim i 2 shkurtit 2006, paragrafi 22).

52. Megjithatë, Gjykata vëren se në ato raste kur statusi i viktimës u është akorduar të afërmve të afërt, duke i lejuar ata të parashtronin një kërkesë në lidhje me ankesat e tyre, përkatësisht në kuadër të nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ mori parasysh faktin nëse parashtruesit mund të kishin interes material në bazë të efektit të drejtpërdrejtë në të drejtat e tyre monetare (shih rastet e Gjykatës: KI211/22, parashtrues: *IsmajI Ipshi, Bashkim Ipshi, Gjevdet Ipshi, Bekim Ipshi dhe Besim Ipshi*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 tetorit 2024, paragrafi 79; dhe rastin e GJEDNJ-së: *Micallef kundër Maltës,* kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 48).

53. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është familjar i të ndjerit YU. Parashtruesi i kërkesës më 16 prill 2019, kishte kërkuar vazhdimin e procedurës gjyqësore si trashëgimtari i YU në procedurë në Gjykatën Themelore. Gjykata Themelore ka legjitimuar parashtruesin e kërkesës si trashëgimtar i YU dhe se i njëjti është person me interes material për rezultatin përfundimtar të procedurave (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KI53/24, parashtrues i kërkesës *Leutrim Shala*, Aktvendim për papranueshmëri i 4 shtatorit 2025, paragrafi 41; dhe rastin e GJEDNJ-së, *Selimi dhe Krasniqi kundër Serbisë*, nr. 20641/20 dhe 20644/20, Aktgjykim i 3 qershorit 2025, paragrafi 121).

54. Gjykata shqyrton tutje nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:
(...)
(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

55. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara nëpërmjet paragrafit 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

56. Gjykata rikujton se objekti i kontestit gjyqësor pranë Gjykatës Themelore ndërlidhet me të drejtën e pronësisë së parashtruesit të kërkesës përkitazi me paluajtshmërinë e evidentuar si ngastër kadastrale [nr. 1218], me kulturë mal i klasës II, në sipërfaqe prej 06.84.27 ha sipas fletëposedimit [nr. 230], në Zonën Kadastrale Brovinë, Komuna e Gjakovës. Procedura gjyqësore ishte iniciuar më 17 korrik 2001, kur parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi për vërtetimin e së drejtës së pronësisë kundër O.P. Ekonomia e Pyjeve-Gjakovë, tani Agjencia Pyjore e Kosovës, duke pretenduar se prona kontestuese ishte trashëguar brez pas brezi nga paraardhësit e tij dhe se regjistrimi i saj në emër të palës së paditur ishte bërë gabimisht. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, procedura ishte ndërprerë për shkak të nevojës për rregullimin subjektiv të padisë, ndërsa parashtruesi i kërkesës më 17 shkurt 2005 kishte kërkuar vazhdimin e procedurës dhe kishte bërë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv. Më pas, për shkak të vdekjes së disa prej palëve në procedurë, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [C. nr. 165/2005] të 29 qershorit 2012, kishte vendosur ndërprerjen e procedurës deri në momentin kur trashëgimtarët e tyre do ta merrnin përsipër procedurën gjyqësore ose kur do të thirreshin nga gjykata sipas propozimit të APK-së.

57. Gjykata më tej rikujton se më 16 prill 2019, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për vazhdimin e procedurës gjyqësore, duke pretenduar se tashmë kishin pushuar arsyet e ndërprerjes së procedurës dhe se, në cilësinë e trashëgimtarit, kërkonte vazhdimin e shqyrtimit të çështjes pronësore. Në vijim, parashtruesi i kërkesës në disa raste i ishte drejtuar Gjykatës Themelore me kërkesa për caktim urgjent të seancës, përkatësisht më 24 janar 2020, 7 mars 2022, 16 nëntor 2023, 1 korrik 2025 dhe 29 dhjetor 2025. Më 4 korrik 2024 dhe 24 korrik 2024, Gjykata Themelore kishte mbajtur seanca përgatitore, ndërsa në seancën e 24 korrikut 2024 kishte aprovuar ndryshimin e padisë dhe kishte nxjerrë disa urdhra proceduralë, përfshirë nxjerrjen e ekspertizës gjeodezike dhe sigurimin e shkresave të lëndëve paraprake. Më 29 dhjetor 2025, lënda kishte kaluar në trajtim tek gjyqtari tjetër FH, ndërsa më 4 qershor 2026 ishte ricaktuar seanca përgatitore për shkak të ndërrimit të gjyqtarit të çështjes.

58. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se si rezultat i kohëzgjatjes së paarsyeshme të procedurës civile pronësore në lëndën [C. nr. 286/19], atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

59. Andaj, Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm

60. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës, përcakton: *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme […]".*

61. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se "*Çdo person ka të drejtë që […] të dëgjohet […] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë […], e cila do të vendosë […] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij […] civile […]".*

62. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

63. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshinë, por nuk kufizohet në rastet (i) KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha,* Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović,* Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana,* Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iv) KI177/19, parashtrues *NNT "Sokoli",* Aktgjykim i 29 marsit 2021; dhe (vi) KI142/23 parashtrues "*Fadil Berisha*", Aktgjykim i 12 shkurtit 2025. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ, përfshirë rastet (i) *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (iii) *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iv) *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (v) *Mikulić kundër Kroacisë,* nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; (vi) *Scordino kundër Italisë* (nr.1), [DhM] nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (vii) *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (viii) *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (ix) *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; (x) *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010; dhe (xi) *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.

64. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se (i) përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë

llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50; *Comingersoll kundër Portugalisë,* cituar më lart, paragrafi 24; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës KI06/21, cituar më lart, paragrafët 50-75; dhe KI19/21, cituar më lart, paragrafi 82; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 47).

65. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) kompleksiteti i rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Surmeli kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 128; si dhe rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 65; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 48).

66. Përkitazi me (i) kompleksitetin e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor, mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih, në mënyrë të ngjashme rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafët 66-67 KI142/23, cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastet e GJEDNJ-së, *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210).

67. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë, dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se, vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 68; dhe *Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i atribuohet autoriteteve shtetërore, dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih, rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 68-70; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 50).

68. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe sjelljet e institucioneve publike;

gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor; gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmangë përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra (shih, rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafët 71-73; KI06/21, cituar më lart, paragrafi 67; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 51).

69. Sa i përket (iv) rëndësisë së e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve, të cilat, për shkak të natyrës së tyre, duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "*sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*"; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull, rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih, rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 74; KI06/21, cituar më lart, paragrafi 67; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 52).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

70. Gjykata thekson se periudha që do të llogaritet për çështje të gjykimit të drejtë brenda afatit të arsyeshëm do të përfshijë: (i) periudhën kur është paraqitur padia për vërtetim të pronësisë nga paraardhësi i parashtruesit të kërkesës më 17 korrik 2001 e deri më 29 qershor 2012, ku Gjykata Themelore ndërpreu procedurën për shkak të vdekjes së paraardhësit të parashtruesit të kërkesës (periudha 7 korrik 2001 – 29 qershor 2012); dhe (ii) periudhën kur parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesës për vazhdim të procedurës për vërtetim të pronësisë më 16 prill 2019 dhe vazhdimin e procedurës deri në shtator 2026 (periudha 16 prill 2019 deri shtator 2026).

71. Gjykata po ashtu thekson se periudha nga 29 qershori 2012 e deri më paraqitjen e kërkesës për vazhdim të procedurës për vërtetim të pronësisë nga parashtruesi i kërkesës më 16 prill 2019, nuk do të llogaritet për çështje të afatit të arsyeshëm sepse vonesat në këtë periudhë nuk mund t'i atribuohen Gjykatës Themelore (periudha 29 qershor 2012-16 prill 2019).

72. Gjykata rikujton se më 16 prill 2019, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për vazhdimin e procedurës gjyqësore në lëndën civile pronësore [C. nr. 286/19], duke pretenduar se kishin pushuar arsyet e ndërprerjes së procedurës dhe se kërkonte vazhdimin e shqyrtimit të çështjes në cilësinë e trashëgimtarit. Pas kësaj date, parashtruesi i kërkesës në vazhdimësi kishte ndërmarrë hapa proceduralë për përshpejtimin e

procedurës, duke dorëzuar kërkesa për caktimin urgjent të seancës pranë Gjykatës Themelore. Gjykata vëren se vetëm gjatë vitit 2024 janë mbajtur dy seanca përgatitore, ndërsa procedura ende nuk ka përfunduar me ndonjë vendim meritor. Për më tepër, për shkak të ndërrimit të gjyqtarit të rastit, seanca përgatitore ishte caktuar sërish më 4 qershor 2026. Më pastaj, më 24 korrik 2026 është mbajtur seancë përgatitore për vazhdim të procedurës së ndërprerë dhe më 16 shtator 2026 është mbajtur seancë për caktim të ekspertit të gjeodezisë i cili duhet të prezantojë raport brenda tridhjetë (30) ditësh, çka nënkupton se procedura vazhdon ende pranë Gjykatës Themelore.

73. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se periudha relevante për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës llogaritet për periudhën 17 korrik 2001 e deri më 29 qershor 2012 dhe nga 16 prilli 2019, kur parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar vazhdimin e procedurës gjyqësore. Gjykata vëren se nga ajo kohë procedura ka vazhduar të zhvillohet pranë Gjykatës Themelore pa ndonjë vendim përfundimtar dhe se lënda ende ndodhet në trajtim në këtë gjykatë e cila ka mbajtur seanca përgatitore më 24 korrik dhe 16 shtator 2026. . Rrjedhimisht, periudha që do të merret parasysh nga Gjykata është 17 korrik 2001 e deri më 29 qershor 2012 dhe periudha 19 prill deri më 16 shtator 2026.

74. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, rasti i tij ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë (i) kompleksitetin e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(i) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit

75. Për sa i përket ndërlikueshmërisë së rastit, Gjykata vëren se objekti i kontestit ndërlidhet me vërtetimin e së drejtës së pronësisë mbi një paluajtshmëri dhe se gjatë procedurës janë paraqitur çështje lidhur me legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve, ndryshimin e padisë, si dhe nevojën për administrimin e ekspertizës gjeodezike dhe verifikimin e mundshëm të litispendencës përmes sigurimit të shkresave të lëndëve paraprake. Megjithatë, Gjykata vlerëson se pavarësisht këtyre rrethanave procedurale, çështja konkrete nuk rezulton të jetë posaçërisht e ndërlikuar në atë masë sa të justifikojë mosnxjerrjen e një vendimi përfundimtar për më shumë se tetëmbëdhjetë (18) vite pas kërkesës për vërtetim të pronësisë.

76. Për më tepër, Gjykata vëren se nga viti 2001 deri në 2012 e pastaj nga viti 2019 deri në 2026 nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprime të vazhdueshme procedurale nga Gjykata Themelore për avancimin e procedurës, ashtu që vetëm në korrik të vitit 2024 dhe në korrik dhe shtator 2026 janë mbajtur seanca përgatitore, ndërsa edhe pas këtyre veprimeve procedura ka vazhduar të mbetet në fazë përgatitore. Aq më tepër, kompleksiteti i kësaj çështje civile pronësore nuk mund të justifikojë mungesën e një vendimi përfundimtar edhe pas vitit 2026, kur procedura ende vazhdon në shkallë të parë.

(ii) Përkitazi me sjelljen e palës

77. Lidhur me sjelljen e palës, Gjykata përsëritë se parashtruesi i kërkesës më 16 prill 2019 kishte kërkuar vazhdimin e procedurës gjyqësore, duke pretenduar se kishin pushuar arsyet e ndërprerjes së procedurës. Po ashtu, në disa raste ai i ishte drejtuar Gjykatës Themelore me kërkesa për caktimin urgjent të seancës, përkatësisht më 24 janar 2020, 7

mars 2022, 16 nëntor 2023, 1 korrik 2025 dhe 29 dhjetor 2025. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka qenë aktiv gjatë procedurës dhe ka ndërmarrë hapa proceduralë me qëllim të përshpejtimit të saj. Në këtë kontekst, Gjykata, duke pasur parasysh veprimet e ndërmarra nga parashtruesi i kërkesës, vlerëson se parashtruesi i kërkesës duke qenë palë në procedurë nuk i ka kontribuar vonesave por ishte i vëmendshëm në ndërmarrjen e hapave proceduralë, dhe se i njëjti nuk kishte përdorur mënyra për të shtyrë procedurën.

(iii) Sjellja e autoriteteve kompetente

78. Gjykata, në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve kompetente, përkatësisht të Gjykatës Themelore, thekson se pas kërkesës së paraardhësit të parashtruesit të kërkesës për vërtetim të pronësisë me 17 korrik 2001 dhe me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për vazhdimin e procedurës më 16 prill 2019, për një periudhë shumë vjeçare nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprime efektive procedurale për zgjidhjen e çështjes. Në vitet 2024 dhe 2026 janë mbajtur katër seanca përgatitore, ndërsa procedura ende nuk ka kaluar në fazën e shqyrtimit kryesor dhe nuk është nxjerrë ndonjë vendim përfundimtar. Gjykata po ashtu vëren se gjatë procedurës ka pasur shtyrje të seancave, ndërrim të gjyqtarit të rastit, si dhe veprime lidhur me sigurimin e shkresave të lëndëve paraprake, vazhdim të procedurës së ndërprerë dhe caktim të ekspertit të gjeodezisë. Megjithatë, këto rrethana procedurale nuk mund të arsyetojnë faktin se për më shumë se tetëmbëdhjetë (18) vjet procedura civile pronësore ka mbetur e pazgjidhur në shkallë të parë.

79. Duke pasur parasysh të lartcekurat, si dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga Gjykata Themelore, Gjykata thekson se përgjegjësia për zvarritjen e lëndës nuk mund t'i atribuohet, në këtë rast, sjelljes së parashtruesit të kërkesës por Gjykatës Themelore, e cila pa ndonjë arsye konkrete nuk kishte arritur të ndërmarrë veprime efektive procedurale për zgjidhjen e çështjes civile pronësore për një periudhë të gjatë kohore. Gjykata vëren se pas kërkesës së paraardhësit të parashtruesit të kërkesës në vitin 2001 dhe kërkesës së së parashtruesit të kërkesës për vazhdimin e procedurës më 16 prill 2019, për disa vite nuk ishin ndërmarrë veprime procedurale për avancimin e çështjes, ashtu që deri më 4 korrik 2024, Gjykata Themelore nuk kishte bërë asnjë hap procedural, kurse më pas përgjatë vitit 2024 janë mbajtur dy seanca përgatitore, ndërsa në vitin 2026 janë mbajtur dy seanca përgatitore me ç' rast Gjykata Themelore kishte aprovuar ndryshimin e padisë, kishte caktuar ekspertizën gjeodezike dhe kishte urdhëruar sigurimin e shkresave të lëndëve paraprake. Megjithatë, procedura ka vazhduar të mbetet ende në fazën përgatitore dhe nuk rezulton të jetë nxjerrë ndonjë vendim meritor për rastin në fjalë. Gjykata po ashtu vëren se ndërrimi i gjyqtarit të procedurës, sigurimi i shkresave të lëndëve paraprake dhe caktimi i ekspertit të gjeodezisë kanë mundur të ndikojnë në zgjatjen e procedurës, mirëpo këto rrethana nuk mund të justifikojnë faktin se lënda civile pronësore e parashtruesit të kërkesës ka mbetur e pazgjidhur për më shumë se tetëmbëdhjetë (18) vite në shkallë të parë. Gjykata vlerëson se Gjykata Themelore, me mos zhvillimin efikas të procedurës dhe mosnxjerrjen e një vendimi përfundimtar, ka kontribuar në zgjatjen e paarsyeshme të procedurës civile pronësore.

(iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor

80. Lidhur me këtë, Gjykata ka sqaruar kategoritë e caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Çështja e parashtruesit të kërkesës, jo domosdoshmërisht hyn në atë kategori.

81. Megjithatë, Gjykata konsideron se tejzgjatja e procedurës në fjalë për më shumë se tetëmbëdhjetë (18) vite në vetëm një instancë gjyqësore është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe si e tillë është në kundërshtim me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.

82. Si përfundim, Gjykata marrë parasysh aplikimin kumulativ të kritereve të lartcekura, konstaton se (i) megjithëse rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest civil pronësor, rasti nuk rezulton të jetë i një natyre aq të ndërlikuar sa të justifikojë mosnxjerrjen e një vendimi përfundimtar për më shumë se tetëmbëdhjetë (18) vite; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës, por ka ndërmarrë vazhdimisht hapa proceduralë për përshpejtimin e saj; ndërsa (iii) Gjykata Themelore ka dështuar të organizojë procedurën në mënyrë efikase dhe të nxjerrë një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm kohor, përkundër faktit se çështja vazhdon të mbetet ende në fazën e procedurës përgatitore.

83. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

84. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se, pas këtij aktgjykimi nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata Themelore duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmbyllur çështjen juridike të parashtruesit të kërkesës me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij aktgjykimi.

Përkitazi me kërkesën për kompensim

85. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që t'i kompensohet dëmi material dhe jomaterial në shumën prej 100,000.00€ (njëqind mijë euro), si pasojë e zvarritjes së paarsyeshme të procedurës gjyqësore.

86. Lidhur me këtë, Gjykata përsërit se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore. (shih, rastet KI19/21, cituar më lart, paragrafi 115; KI06/21, cituar më lart, paragrafi 84; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 68; e KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim, i 22 dhjetorit 2022, paragrafi 104; dhe KI43/26, parashtrues *Genc Hamza*, Aktgjykim, i 25 qershorit 2026, paragrafi 65).

87. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar dhe në rrethanat e rastit konkret sërish ripërsëritë se Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë të përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligj për të akorduar kompensim për parashtruesit e kërkesave në rastet e konstatimit të shkeljes së drejtave dhe lirive të tyre. Si rrjedhojë, Gjykata në mungesë të një kompetence apo autorizimi, kërkesat e parashtruesve të kërkesave për kompensim nuk i shqyrton dhe vlerëson në procedurat para saj. Gjykata në vendimmarrjen e saj vetëm ka nënvizuar se individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jo-material pranë gjykatave të rregullta (shih, rastet e Gjykatës KI142/23, cituar më lart, paragrafi 69; dhe KI06/21, cituar më lart, paragrafi 85).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 4 nëntor 2026, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm;

III. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore në Gjakovë që jo më larg se 5 maj 2027, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës;

IV. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;

V. TË KONSTATOJË që ky aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Remzije Istrefi-Peci	Nexhmi Rexhepi